

ZBATIMI I PARTNERITETIT

PARTNERI DREJTUES

Autoriteti shëndetësor vendas “Veneto Orientale” nr. 10, është pjesë e sistemit shëndetësor të rajonit të Veneto. Ai gëzon autoritetin politik-bërës në territorin e tij dhe ofron një gamë të gjerë shërbimesh parësorë dhe dytësore perkujdesi, si dhe shërbimesh sociale. Ai punon në partneritet të ngushtë me degën lokale/rajonale të AVIS dhe është pjesë e Departamentit Provincial të Transfuzionit të Provincës së Venecias.

Shoqata Italiane e Dhuruesve të Gjankut (AVIS) e kontraktuar nga Shërbimi i Grumbullimit të Gjankut të Provincës së Venecias

është një organizatë jo-qeveritare e përfshirë në aktivitete që lidhen me dhurimin e gjakut.

Fondacioni i Universitetit Ca' Foscari

është instrument i Universitetit Ca' Foscari të Venecias. Ai synon krijimin e një pike të vetme reference për këtë Universitet. Fondacioni koncepton, zbaton dhe manazhon programe këshillimi, kërkimi dhe trainimi.

Shoqata Italiane e Dhuruesve të Gjankut (AVIS), dega rajonale e Friuli Venezia Giulia

është degë e shoqatës kombëtare AVIS dhe përfshihet kryesisht në aktivitete promovionale që kanë të bëjnë me dhurimin e gjakut me objektiv shkollat e mesme.

Shoqata Italiane e Dhuruesve të Gjankut (AVIS) dega rajonale e Emilia Romagna

është degë e shoqatës kombëtare AVIS dhe përfshihet kryesisht në aktivitete promovionale që kanë të bëjnë me dhurimin e gjakut.

Kryqi i Kuq Slloven

Shoqata është organizatë kombëtare humanitare, vullnetare, ndihmëse e Qeverisë së Republikës së Sllovenisë që ka detyra publike në fushën e dhurimit të gjakut.

Qendra e Transfuzionit të Gjankut të Sllovenisë

kryen mbledhjen, testimin dhe përpunimin e gjakut, mirëmban depot qendrore të gjakut, testimin e transfuzionit, aktivitete të mjekësisë klinike të transfuzionit dhe administrimin dhe manazhimin e cilësisë së sistemit.

Kryqi i Kuq Kroat

është një organizatë kombëtare humanitare, vullnetare, ndihmëse e Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

Instituti Kroat i Mjekësisë së Transfuzionit

është qendra më e madhe e transfuzionit të Republikës së Kroacisë.

Ministria Shqiptare e Shëndetësisë

Është organi politikëbërës dhe manaxhuesi i Sistemit Shëndetësor Kombëtar në Shqipëri

Kryqi i Kuq Shqiptar

është një organizatë kombëtare humanitare e pavarur, ndihmëse e pushtetit në Republikën e Shqipërisë.



Bessy është një projekt bashkëpunimi ndërkufitar që synon dhënien e një përgjigjeje të përbashkët efektive problemeve të mungesës dhe sigurisë së gjakut të dhuruar, duke respektuar autonomitë dhe identitetet e gjithë secilit.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është ngritja e një rrjeti të qëndrueshëm politikëbërësish, organizatash joqeveritare dhe institucione të kujdesit shëndetësor të përfshirë në dhurimin e gjakut dhe në promovimin e gjakut si një e mirë etike për kapital shoqëror në zonën e Adriatikut.



The Programme is co-funded by the European Union, Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA)

Deklarim: Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Europian. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht reflektojnë pikëpamjen e Bashkimit Europian.



OBJEKTIVA SPECIFIKË

Të identifikohet një model optimal për dhurimin e mbledhjen e gjakut si në aspektin social ashtu dhe atë ekonomik, duke marrë parasysh efektin mbi kapitalin social.

Të përgatiten kritere të përbashkëta për dhuruesit që kalojnë kufijtë nëpërmjet realizimit të kartës së dhuruesit.

Të rritet rekrutimi dhe mbajtja e dhuruesve vullnetarë, pa pagesë të gjakut.

Të përgatiten fushata promovimi të përbashkëta evropiane, me synim rritjen e numrit të dhuruesve të gjakut nëpërmjet ndërgjegjësimit mbi çështjet e sigurisë së gjakut të dhuruesit potencialë dhe aktualë.

Të forcohet partneriteti mes organizatave joqeveritare, politikë-bërëse dhe institucioneve të transfuzionit të gjakut në nivel vendor, kombëtare e rajonal.

Të ofrohet mundësi në ndërtimin e kapaciteteve për politikë-bërësit, institucionet e kujdesit shëndetësor dhe organizatat joqeveritare të përfshira në dhurimin dhe mbledhjen e gjakut nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, aktiviteteve trajnuese dhe seminareve.

Përgatitja e një qasje të përbashkët dhe marrje informacioni mbi produktin e “kapitalit shoqëror” të dhurimit të gjakut.

AKTIVITETE

Mbledhja dhe analiza e praktikave më të mira.

Listimi i të gjithë palëve të interesuar që përfshihen në dhurimin e gjakut.

Studim mbi kapitalin social që gjenerohet nga dhurimi i gjakut.

Identifikimi i modeleve dhe i instrumenteve më funksionale për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit dhe sigurisë së sistemit të dhurimit të gjakut.

Përgatitja e një modeli të përbashkët komunikimi për promovimin e dhurimit të gjakut.

Përgatitja e një sistemi të integruar informacioni lidhur me manaxhimin e dhuruesve të gjakut.

Përgatitja e një qendre njohurish dhe ekspertize virtuale, bazuar në internet.

Zhvillimi i aktiviteteve trajnuese lidhur me cilësinë dhe sigurinë e dhurimit të gjakut.

Krijimi i një rrjeti kompetent në mbështetje të qeverive kombëtare dhe rajonale.

REZULTATE

Raport mbi analizën krahasuese të sistemeve të transfuzionit dhe kuadrit ligjorë përkatëse.

Raport mbi studimin e kapitalit shoqëror që gjenerohet nga praktika e dhurimit të gjakut.

Zhvillimi i materialeve promovionale të përgatitura për fushatën e përbashkët të komunikimit.

Rekomandime mbi Manaxhimin e integruar të sistemeve të informacionit, lidhur me manaxhimin e dhuruesve të gjakut.

Hedhja në faqen e internetit të projektit të qendrës së njohurive dhe të ekspertizës në internet.

Krijimi i një karte vlerash të rrjetit të kompetencës.

Kartë parimesh së dhuruesve vullnetarë pa pagesë të gjakut.

Rekomandime për politikëbërësit që synojnë përmirësimin e manaxhimit të dhurimit të gjakut.

MËNYRAT E DIFUZIONIT

Websiti Projektit : www.bessyproject.eu

Konferencë ndërmjetëse në Split, Kroaci 2012 | Konferencë përfundimtare në Venecia, Itali 2013

Seminare vendore për përhapjen e informacionit të organizuar nga të gjithë partnerët.

KONTAKTE

Vijorka Roseg
Kryqi i Kuq Kroat
Drejtuese për difuzionin dhe komunikimin
vijorka.roseg@hck.hr

Silva Mitro
Manaxhere e projektit
silva.mitro@ulss10.veneto.it